

Java Globale e Parave, 12-18 Mars, 2018

Rreth Javës Globale të Parave:

Fushatë për të rritur ndërgjegjësimin tek fëmijët dhe të rinjtë që të frymëzohen të mësojnë për çështje të lidhura me financa, për jetë dhe sipërmarrje. Kjo nismë vjen nga organizata globale jofitimprurëse Child & Youth Finance International (CYFI) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). CYFI punon në ristrukturimin e sistemeve financiare me qëllim të aftësisimit ekonomik dhe social të fëmijëve dhe të rinjëve në mbarë botën.

Java globale e parave ka filluar në vitin 2012 dhe atëbotë ka përfshirë 7,8 milionë fëmijë dhe të rinjë të më shumë se 23,700 organizatave në 137 vende.

Cili është qëllimi i Javës Globale të Parasë?

Fëmijët dhe të rinjtë e sotëm duhet të aftësohen t'a kuptojnë rëndësinë e financave dhe të jenë të pajisur me aftësitë që duhet t'i shfrytëzojnë për të krijuar mjete personale për jetesë. Të rinjtë të mësojnë me mençuri t'i menaxhojnë paratë e tyre. Gjithashtu, fëmijët dhe të rinjtë përforcohen dhe u oforhet ndihmë të krijojnë një valë pozitive që do ta zhvillojnë ata, tek familjet e tyre dhe tërë komuniteti.

Pse është e rëndësishme?

Për shkak se fëmijët dhe të rinjtë janë gjenerata e ardhshme e ndryshuesve. Ata janë udhëheqës të biznesit të së nesërme, politikanë, prindër, mësues. Ata e hapin potencialin e tyre kur besojnë në vetvete.

Kush mund të marrë pjesë?

Të gjithë. Kudo. Ska dallim nëse përfaqëson komunitetin, kompaninë apo vendin. Ska dallim nëse është individ, grup apo popullatë e tërë - kushdo që beson në investimin në gjeneratën e ardhshme


Çfarë ndodh gjatë Javës Globale të Parasë?

Java globale e parave përfshin lloje të ndryshme të ngjarjeve dhe aktiviteteve që të krijojë një emocion të të mësuarit dhe taktit ekonomik. Për shembull:

- Folës në panelet e përfshirjes financiare të të rinjve
- Lojëra edukative financiare dhe gara
- Dialogje me politikë-bërësit
- Punëtori interaktive të edukimit financiar
- Ngjarje të hapura
- Vizatim, fotografi, ese dhe video gara me temë financat

- Vizitë të kompanive të sigurimeve, bankave, parlamentit, bizneseve lokale dhe korporatave globale

Rritja dhe zhvillimi i fushatës Globale të Javës së Parave



Grafiku (lartë majtas) tregon numrin e vendeve që mbështesin fushatën dhe marrin pjesë me aktivitete gjatë Javës Globale të Parave,

Grafiku (lartë djathtas) tregon numrin e fëmijëve dhe të rinjve të përfshirë me aktivitete gjatë fushatës për Javën Globale të Parave,

Grafiku (poshtë majtas) tregon numrin e organizatave që mbështesin atë dhe marrin pjesë me aktivitete në Javën Globale të Parave.

Agjencioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve rregullisht mbështet fushatën e Javës Globale të Parave dhe në mënyrë aktive merr pjesë në aktivitete dhe ngjarje të shumta gjatë tërë vitit. Edhe këtë vit, Agjencioni do të fillojë fushatën me vizitë të shkollave ku fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet prezantimit dhe lojërave

shoqërore finaciare do të njihen me kompetencat e saj dhe rolin e sigurimit dhe mbikëqyrjes. Gjatë fushatës, për fëmijët do të organizohen vizita të Agjencionit dhe kompanive të sigurimit, ku të rinjtë do të kenë mundësi për së afërmi të njihen me atë se çka do të thotë sigurim si shërbim financiar apo produkt. Poashtu, për herë të parë këtë vit, Agjencioni do të fillojë me aksionin e ditëve të hapura në Agjencionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Kjo është një mundësi për të gjithë qytetarët e interesuar, me një orar të paracaktuar të mund ta vizitojnë Agjencionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe drejtpërdrejtë të bisedojnë me stafin nëse kanë pyetje nga fusha e aktivitetit të Agjencionit.